**NEW YORKER Albania Sh.p.k.**

**Pasqyrat financiare per vitin financiar qe mbyllet me 31 dhjetor 2021**
**(dhe raporti i audituesit te pavarur)**

EG

Tabela e permbajtjes


**Raporti i audituesit te pavarur** ..... i
**Pasqyra e pozicionit financiar** ..... 1
**Pasqyra e performances** ..... 2
**Pasqyra e te ardhurave gjitheperfshirese** ..... 3
**Pasqyra e ndryshimeve ne kapital** ..... 4
**Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare** ..... 5
**1 Informacion i pergjithshem** ..... 6
**2 Bazat e pergatitjes** ..... 6
**3 Permbledhje e politikave kontabel** ..... 6
**4 Menaxhimi i riskut financiar** ..... 10
**5 Mjetet monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare** ..... 10
**6 Te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit** ..... 10
**7 Te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit** ..... 11
**8 Te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit** ..... 11
**9 Inventari** ..... 11
**10 Aktive afatgjata materiale** ..... 12
**11 Aktive afatgjata jo materiale** ..... 13
**12 Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit** ..... 13
**13 Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit** ..... 13
**14 Te pagueshme ndaj personelit dhe sigurimeve shoqerore** ..... 14
**15 Detyrime tatimore dhe doganore** ..... 14
**16 Detyrime te tjera** ..... 14
**17 Huamarrje** ..... 14
**18 Kapitali aksionar** ..... 14
**19 Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit** ..... 15
**20 Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme** ..... 15
**21 Shpenzime personeli** ..... 15
**22 Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit** ..... 16
**23 Shpenzime financiare** ..... 16
**24 Tatim fitimi** ..... 16
**25 Instrumentat financiare** ..... 17
**26 Transaksionet me palet e lidhura** ..... 19
**27 Ngjarje pas dates se raportimit** ..... 20

Nexia AL

Str. Margarita Tutulani,
Palazzo Viridario 1, 1-st floor,
Tirana, Albania
T: +355 4 223 2726
www.nexia.al

# RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Për Drejtimin e New Yorker Albania Shpk

## Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqerise New Yorker Albania Shpk, te cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2021, pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë si dhe shënimet shpjeguese te pasqyrave financiare, duke perfshire dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale gjëndjen financiare të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2021, rezultatin financiar dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit ("SKK") miratuar me Ligjin Nr.25/2018 datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" ne Shqiperi.

## Baza per Opinion

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyre më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikes për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikes për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikes të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA) qe janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike ne përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit qe kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhëne një baze për opinionin tonë.

## Përgjegjësia e Drejtimit dhe Personave te Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK miratuar me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo pasaktësia.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqerise për të vazhduar në kushtet e vijimësisë se biznesit, zbulimin, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me vijimësinë dhe përdorimin e bazës se vijimesise të kontabilitetit, përveç rasteve kur drejtimi synon të likuidojë Shoqerinë ose të pushojë veprimtarinë, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër realiste përveç kesaj.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqerise.

Str. Margarita Tutulani,
Palazzo Viridario 1, 1-st floor,
Tirana, Albania
T: +355 4 223 2726
www.nexia.al

**Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë dhenia e sigurise së arsyeshme nëse pasqyrat financiare ne tërësi janë pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo pasaktesia, dhe dhenia e raportit te audituesve që përfshin opinionin tonë. Siguri e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci që një kontroll i kryer në përputhje me SNA gjithmonë do të zbulojë një anomali materiale, kur ajo ekziston. Anomalitë mund të lindin nga mashtrimi apo pasaktesia dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato pritet që të ndikojnë vendimet ekonomike te marra nga përdoruesit mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rezikun e gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive, planifikojmë dhe kryejmë proçedurat e auditimit, që u pergjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi, që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për bazat e opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material, që vjen nga mashtrimi është më i lartë se ai që vjen nga gabimet, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, mospërfshirje të qëllimshme, keq paraqitje, apo tejkalim të kontrollit të brëndshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditimin me qëllim hartimin e proçedurave të auditimit, që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njesisë ekonomike.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shënimeve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi të parimit të vijimësisë në kontabilitet dhe, duke u bazuar në evidencën e marrë gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose rrethanat që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e njesisë ekonomike për të vazhduar në kushtet e vijimësisë së biznesit. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmëndjen në raportin tonë të audituesit për paraqitjen e këtij informacioni në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, nëse keto shënime janë të papërshtatshme, për të modifikuar opinionin tonë.
- Në rastet e një misioni për auditimin e një grupi, marrim evidenca auditimi, që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënat financiare të njësive ekonomike ose aktiviteteve tregtare brënda grupit për të shprehur një opinion për pasqyrat financiare të grupit. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikqyrjen dhe cilësinë e auditimit të grupit. Ne jemi të vetmit përgjegjës për opinionin e auditimit.

Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana në të ardhmen mund të detyrojë njesinë ekonomike të mos vazhdojë më në kushtet e vijimësisë së biznesit.

Nexia AL

Str. Margarita Tutulani,
Palazzo Viridario 1, 1-st floor,
Tirana, Albania
T: +355 4 223 2726
www.nexia.al

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje në lidhje me, midis çështjeve të tjera, qëllimin e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brëndshëm që kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Midis çështjeve që ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë, nese ka, ato çështje që kanë qënë më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financare të periudhës aktuale dhe rrjedhimisht jane çështje kryesore auditimi. Ne i përshkruajmë keto çështje në raportin tonë të auditimit përvec rasteve kur ligjet apo regulloret e ndalojnë paraqitjen publike të çështjes ose kur, në raste shumë të rralla, ne vendosim që një çështje nuk duhet komunikuar në raportin tonë të auditimit sepse ndikimi negativ që do kishte, do të tejkalonte mjaftueshëm përfitimet e interesit publik të këtij komunikimi.

**Nexia AL**

Orjana Kalaja
Auditues Ligjor
Tiranë, Shqipëri
25 Mars 2022

**Pasqyra e pozicionit financiar**

| | Shenime | 31dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|---|
| **AKTIVET** | | | |
| **Aktivet afatshkurtra** | | | |
| Mjetet monetare | 5 | 66,126,083 | 46,327,867 |
| Te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit | 6 | 293,945 | 54,164 |
| Te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit | 7 | - | 49,124 |
| Te arketueshme te tjera | 8 | 797,016 | - |
| Inventare | 9 | 18,864,635 | 18,827,774 |
| **Aktive totale afatshkurtra** | | **86,081,679** | **65,258,929** |
| **Aktivet afatgjata** | | | |
| Aktivet materiale | 10 | 35,254,525 | 51,405,758 |
| Aktivet jo-materiale | 11 | 266,332 | - |
| **Aktive totale afatgjata** | | **35,520,857** | **51,405,758** |
| **AKTIVE TOTALE** | | **121,602,536** | **116,664,687** |
| **DETYRIME DHE KAPITALI** | | | |
| **Detyrime afatshkurtra** | | | |
| Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit | 12 | 16,702,815 | 16,871,527 |
| Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit | 13 | 2,171,102 | 2,218,421 |
| Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore | 14 | 971,681 | 708,213 |
| Detyrime tatimore dhe doganore | 15 | 13,651,105 | 4,687,489 |
| Detyrime te tjera | 16 | 2,800,841 | 2,326,846 |
| Huamarrje | 17 | - | 67,725,750 |
| **Totali i detyrimeve afatshkurtra** | | **36,297,544** | **94,538,246** |
| **DETYRIME TOTALE** | | **36,297,544** | **94,538,246** |
| **KAPITALI DHE REZERVAT** | | | |
| Kapitali i nenshkruar | 18 | 13,000,000 | 13,000,000 |
| Humbja e akumuluar | | 9,126,441 | (2,141,064) |
| Fitimi i vitit | | 63,178,551 | 11,267,505 |
| **Totali i Kapitalit** | | **85,304,992** | **22,126,441** |
| **TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT** | | **121,602,536** | **116,664,687** |

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet, pjese perberese e pasqyrave financiare nga faqja 6 deri ne 21.



EG

## Pasqyra e performances

| | Shenime | Viti i mbyllur 31 dhjetor 2021 | Viti i mbyllur 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|---|
| Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit | 19 | 256,544,015 | 164,493,565 |
| Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme | 20 | (101,687,762) | (78,314,002) |
| Shpenzime te personelit | 21 | (10,919,939) | (8,292,931) |
| Shpenzime amortizimi | 10,11 | (16,334,825) | (16,245,157) |
| Shpenzime te tjera shfrytezimi | 22 | (48,636,899) | (39,705,548) |
| Shpenzime financiare | 23 | (3,052,751) | (8,158,834) |
| **Fitimi para tatimit** | | **75,911,839** | **13,777,093** |
| Shpenzimi i tatimit mbi fitimin | 24 | (12,733,288) | (2,509,588) |
| **Fitimi i vitit** | | **63,178,551** | **11,267,505** |

**Miratuar nga:**

**Helene Steiner**

**Administrator**

**Pergatitur nga:**

**Andi Pacani**

**Kontabilist i miratuar**

NEW YORKER
NUIS: L81507029T

Pasqyra e performances duhet lexuar se bashku me shenimet, pjese perberese e pasqyrave financiare nga faqja 6 deri ne 21.



EG

**Pasqyra e te ardhurave gjitheperfshirese**

| | Shenime | Viti i mbyllur 31 dhjetor 2021 | Viti i mbyllur 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|---|
| Fitimi i vitit | | 63,178,551 | 11,267,505 |
| Te ardhura te tjera gjitheperfshirese per vitin | | - | - |
| **Totali i te ardhurave gjitheperfshirese per vitin** | | **63,178,551** | **11,267,505** |

Pasqyra e te ardhurave gjitheperfshirese duhet lexuar se bashku me shenimet, pjese perberese e pasqyrave financiare nga faqja 6 deri ne 21.



EG

**Pasqyra e ndryshimeve ne kapital**

| | Kapitali i nenshkruar | Fitimi i pashperndare | Fitimi i vitit | Totali |
|---|---|---|---|---|
| **Pozicioni financiar me 1 janar 2020** | 13,000,000 | (2,141,064) | - | **10,858,936** |
| Fitimi i vitit | - | - | 11,267,505 | **11,267,505** |
| **Pozicioni financiar me 31 dhjetor 2020** | **13,000,000** | **(2,141,064)** | **11,267,505** | **22,126,441** |
| **Pozicioni financiar me 1 janar 2021** | 13,000,000 | (2,141,064) | 11,267,505 | 22,126,441 |
| Fitimi i vitit | - | - | 63,178,551 | **63,178,551** |
| Transferimi ne fitimin e pashperndare | | 11,267,505 | (11,267,505) | - |
| **Pozicioni financiar me 31 dhjetor 2021** | **13,000,000** | **9,126,441** | **63,178,551** | **85,304,992** |

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet lexuar se bashku me shenimet, pjese perberese e pasqyrave financiare nga faqja 6 deri ne 21.



EG

## Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare

| | Shenime | Viti i mbyllur 31 dhjetor 2021 | Viti i mbyllur 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|---|
| **Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i shfrytezimit** | | | |
| Fitim i vitit | | **63,178,551** | **11,267,505** |
| Rregullimet per shpenzimet jomonetare: | | | |
| *Shpenzime amortizimi* | *10* | 16,334,825 | 16,245,157 |
| *Zhvleresimi i aktiveve fikse* | *10* | - | 295,051 |
| **Ndryshimet ne aktivet dhe detyrimet nga aktiviteti i shfrytezimit:** | | | |
| *Renie/(rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera* | *6,7,8* | *(987,673)* | *5,734,177* |
| *Renie/(rritje) ne inventare* | *9* | *(36,861)* | *2,985,653* |
| *Rritje/(renie) ne detyrimet e pagueshme* | *12,13* | *(216,031)* | *2,661,993* |
| *Rritje/(renie) ne detyrime per punonjesit* | *14* | *263,468* | *(456,674)* |
| *Rritje/(renie) ne detyrime te tjera* | *15,16* | *9,437,611* | *5,427,507* |
| **Mjete monetare neto ne aktivitetin e shfrytezimit** | | **87,973,890** | **44,160,369** |
| **Fluksi i Mjeteve Monetare ne aktivitetin e investimit** | | | |
| *Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale* | | (449,924) | (1,624,538) |
| **Mjete monetare neto ne aktivitetin e investimit** | | **(449,924)** | **(1,624,538)** |
| **Fluksi i Mjeteve Monetare ne aktivitetin e financimit** | | | |
| *Hua te arketuara* | | - | 6,296,000 |
| *Pagesa per huate* | | (67,725,750) | (35,986,250) |
| **Mjete monetare neto ne aktivitetin e financimit** | | **(67,725,750)** | **(29,690,250)** |
| **Rritje/(renie) neto ne mjete monetare dhe ekuivalente** | | **19,798,216** | **12,845,581** |
| **Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare ne fillim te vitit** | | **46,327,867** | **33,482,286** |
| Efekti i luhatjeve te kursit te kembimit te mjeteve monetare | | - | - |
| **Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare ne fund te vitit** | | **66,126,083** | **46,327,867** |

Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare duhet lexuar se bashku me shenimet, pjese perberese e pasqyrave financiare nga faqja 6 deri ne 21.



EG

## 1 Informacion i pergjithshem

New Yorker Albania Sh.p.k. (me poshte "Shoqeria") eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne pronesi te plote te kompanise gjermane New Yorker Retail International GmbH. Kompania eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me 07 Mars 2018 me NUIS L81507029T. Selia ligjore e shoqerise eshte ne rrugen "Ibrahim Rugova", objekti nr. 40, Hyrja nr. 2, Apartamenti nr. 3, Tirane.

Aktiviteti kryesor i shoqerise eshte importi dhe tregtia me pakice e veshjeve. Shoqeria operon nepermjet nje dyqani, i cili ndodhet ne Qendren Tregtare Univers ne Tirane.

Shoqeria kishte 13 (trembedhjete) punonjes me 31 dhjetor 2021 (2020: 9).

## 2 Bazat e pergatitjes

### (a) Deklarata e perputhshmerise se pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare bashkengjitur jane pergatitur ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara.

### (b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

### (c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten ne Leke, e cila eshte monedha funksionale e shoqerise.

### (d) Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara kerkon qe drejtimi te kryeje gjykime, vleresime dhe supozime te cilat ndikojne ne aplikimin e politikave dhe shumave te raportuara te aktiveve dhe detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve.

Vleresimet dhe supozimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi rishikohet dhe ne periudhat e ardhme qe ndikohen.

## 3 Permbledhje e politikave kontabel

### (a) Aktivet afatgjate materiale

*(i) Njohja dhe vleresimi*

Aktivet materiale jane vleresuar me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvleresimi (nese ka).

*(ii) Amortizimi*

Amortizimi llogaritet me metoden lineare, me norma te cilat jane te peraferta me jetegjatesine mesatare te parashikuar te perdorimit. Toka dhe aktivet ne proces nuk amortizohen.

Normat e amortizimit te perdorura per amortizimin e aktiveve materiale jane te paraqitura si me poshte:

| | |
|---|---|
| ▪ Permiresimet e ambjenteve me qira | 20% |
| ▪ Instalime teknike | 20% |
| ▪ Pajisje informative | 25% |
| ▪ Pajisje zyre | 20% |



EG.

## 3 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

### (b) Aktivet afatgjata jo-material

*(i) Njohja dhe vleresimi*

Aktivet jo-materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvleresimi, (nese ka).

*(ii) Amortizimi*

Aktivet jo-materiale amortizohen me norme vjetore 25%.

### (c) Instrumentat financiare

Shoqeria mban vetem instrumente financiare jo-derivative, qe perfshijne llogari te arketueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, kredi dhe hua, dhe llogari te pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivative jane matur fillimisht me vleren e drejte plus kostot e transaksionit qe jane te lidhura drejtperdrejt me pervetesimin e tyre.

*Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare*

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to perfshijne vlerat ne arke, llogari rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose me pak, te cilat jane objekt i nje rreziku jo domethenes te ndryshimeve ne vlere dhe perdoren nga shoqeria ne administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to mbahen me koston e amortizuar.

*Kerkesa per arketim*

Kerkesat per arketim njihen fillimisht me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te pakesuara per humbjet nga zhvleresime.

*Llogari te pagueshme*

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te amortizuar

*Huamarrjet*

Huamarrjet nga aksioneret njihen fillimisht me koston histiorke. Huamarrje te tjera njihen fillimisht me vleren e drejte. Huammarjet mbarten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

*Te tjera*

Instrumenta financiare te tjere jo-derivative maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv, dhe duke zbritur humbjet nga zhvleresimi.

### (d) Inventaret

Inventaret perfshijne mallra te blere dhe te mbajtur per shitje ne rrjedhen normale te shoqerise.. Pas njohjes, inventaret maten me vleren me te ulet midis kostos dhe çmimit te vleresuar te shitjes pakesuar me kostot per t'u perfunduar dhe shitur.

Kostot e drejtperdrejta te inventarit perfshijne, perveç çmimit te blerjes, edhe te gjitha kostot e tjera qe nevojiten per te sjelle inventarin ne gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese. Kostoja e inventarit llogaritet duke perdorur metoden FIFO.



EG

## 3 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

### (e) Provigjonet

Nje provigjion njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar, Shoqeria ka nje detyrim aktual ligjor apo konstruktiv i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe eshte e mundur qe te kerkoje flukse dalese monetare per shlyerjen e tij. Provigjonet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme skontimi para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimin ne fjale

### (f) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i shoqerise njihet me vleren nominale.

### (g) Njohja e te ardhurave

Te ardhurat perfshijne vleren e drejte te shumes se marre ose qe eshte per t'u marre nga shitja e mallrave gjate aktivitetit te zakonshem te Shoqerise. Te ardhurat paraqiten neto nga tatimi mbi vleren e shtuar, kthimet dhe uljet.

Te ardhurat njihen kur risqet dhe perfitimet lidhur me pronesine e mallrave jane transferuar tek bleresi. Klientet marrin kontrollin e produkteve kur mallrat u shiten ne dyqan dhe te ardhurat njihen ne kete moment. Pagesat behen me para ne dore ose me karte krediti ne momentin e shitjes. Kthimet e mallrave shkembehen me mallra te tjere ose me para. Te ardhurat njihen kur mallrat ofrohen dhe jane pranuar nga klientet ne masen qe ka shume te ngjare qe nuk do te ndodhe nje ndryshim i rendesishem ne shumen e te ardhurave kumulative te njohura. Shuma e te ardhurave te njohura rregullohet per kthimet e pritshme, te cilat vleresohen bazuar ne te dhenat historike per lloje specifike te mallrave.

### (h) Perfitimet e punonjesve

*Sigurimet shoqerore te detyrueshme*

Shoqeria paguan vetem sigurimet shoqerore dhe shendetesore te detyrueshme bazuar ne legjislacion Shqiptar. Kontributet e shoqerise ngarkohen ne fitim ose humbje kur ato ndodhin.

### (i) Shpenzimet

*Shpenzimet operative*

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

### (j) Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat nga interesi prej llogarive bankare dhe fitimet neto nga kursi i kembimit te cilat njihen ne fitim ose humbje. Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet e interesit dhe humbjet neto nga kursi i kembimit qe njihen ne fitim ose humbje.



EG

## 3 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

### (k) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin/(humbjen) e vitit perfshin tatimin e periudhes aktuale dhe tatimin e shtyre. Tatimi mbi fitimin njihet ne fitim ose humbje perveç pjeses qe lidhet me zera te njohur ne pasqyren e te ardhurave permbledhese.

Tatimi aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke perdorur normen tatimore ne fuqi ose qe hyn ne fuqi menjehere ne daten e raportimit.

Tatimi i shtyre eshte llogaritur duke perdorur metoden e detyrimit ne bilanc, nga diferencat e perkohshme ndermjet vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyrimeve per qellime raportimi financiar dhe bazes tatimore. Shuma e tatimit te shtyre eshte llogaritur bazuar ne metoden e realizimit ose kompensimit te vlerave kontabel te aktiveve dhe detyrimeve, duke perdorur shkalle tatimore qe jane ne fuqi ose qe hyjne ne fuqi menjehere ne daten e raportimit. Nje aktiv tatimor i shtyre njihet per aq sa eshte e mundur qe fitimi i tatueshem i ardhshem do te jete i disponueshem kundrejt te cilit aktivi te mund te perdoret. Aktivi tatimor i shtyre zvogelohet per aq sa nuk eshte e mundur te realizohet perfitim fiskal.

### (l) Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se raportimit. Diferencat nga kursi i kembimit qe rrjedhin nga konvertimi njihen ne fitim ose humbje, perveç diferencave nga kursi i kembimit qe rrjedhin nga konvertimi i huave nga aksioneret te cilat njihen ne te ardhurat permbledhese.

### (m) Vazhdimesia e biznesit COVID-19

Perhapja e Coronavirus (COVID-19) ne janar 2020 dhe zgjerimi i saj ne nje numer te madh vendesh beri qe shperthimi i virusit te klasifikohej si nje pandemi nga Organizata Boterore e Shendetesise.

Qe nga ajo kohe, masat qe po merren per te luftuar virusin po japin efekt te rendesishem, jo vetem tek njerezit, por edhe ne aktivitetin ekonomik. Pasojat e COVID-19 nuk krijojne pasiguri qe hedh dyshime mbi aftesine e shoqerise per te vazhduar aktivitetin e saj. Ndikimi i COVID-19 ne performancen e ardhshme dhe per rrjedhoje ne matjen e disa aktiveve dhe detyrimeve ose ne likuiditet mund te jete i rendesishem dhe per kete arsye mund te kerkoje dhenien e informacioneve shpjeguese ne pasqyrat financiare, por menaxhimi ka vendosur qe ato nuk krijojne nje pasiguri materiale qe hedh dyshime te rendesishme mbi aftesine e njesise ekonomike per te vazhduar ne vijimesi.

Ne daten e pergatitjes se ketyre pasqyrave financiare Shoqeria vazhdon te permbushe detyrimet e saj dhe per kete arsye ajo vazhdon te zbatoje parimin e vazhdimesise per pergatitjen e pasqyrave financiare.



EG

## 4 Menaxhimi i riskut financiar

Shoqeria eshte ekspozuar ndaj rreziqeve te meposhtme nga perdorimi i instrumenteve financiare:

- Risku i kredise
- Risku i likuiditetit
- Risku i tregut

### *(a) Risku i kredise*

Risku i mos-pageses ekziston kur pala tjeter nuk mund te permbushe detyrimet per pagesen e llogarive te arketueshme.

### *(b) Risku i likuiditetit*

Shoqeria duhet te permbushe nevojat per mjete monetare, kryesisht per kostot e shfrytezimit qe rrjedhin nga aktivitetet e saj. Ekziston rreziku qe mjetet monetare mund te mos jene te disponueshme per te shlyer detyrimet ne kohen e duhur me nje kosto te arsyeshme. Shoqeria monitoron likuiditetin ne baza periodike ne menyre qe te menaxhoje detyrimet e saj kur ato kerkohen.

### *(c) Risku i tregut*

*Risku i normave te interesit*

Shoqeria kishte marre nje hua nga New Yorker Retail International GmbH dhe ka menaxhuar riskun e interesit. Huaja eshte paguar gjate vitit 2021.

*Risku i kursit te kembimit*

Shoqeria ndermerr transaksione ne Leke dhe Euro. Risku i pozicionit valutor menaxhohet nepermjet parimit te perputhjes se aktiveve me detyrimet. Shoqeria nuk ka hyre ne ndonje marreveshje derivative per kontrata te ardhshme shkembimi me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020.

## 5 Mjetet monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare detajohen si me poshte:

| | 31 dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Llogari bankare ne Leke | 64,117,393 | 42,924,472 |
| Llogari bankare ne Euro | 120,460 | 529,770 |
| Arka | 1,888,229 | 2,873,625 |
| **Total** | **66,126,083** | **46,327,867** |

## 6 Te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit

Te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit paraqesin shitjet me karte krediti si me poshte:

| | 31 dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Pagesa te pamberritura – karte krediti | 293,945 | 54,164 |
| **Totali** | **293,945** | **54,164** |



EG

## 7 Te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit

Te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit detajohen si me poshte:

| | 31 dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit | - | 49,124 |
| **Totali** | **-** | **49,124** |

## 8 Te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit

Te arketueshmet e tjera jane te detajuara si me poshte:

| | 31 dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Shpenzime te shtyra | 797,016 | - |
| **Total** | **797,016** | **-** |

## 9 Inventari

Inventari detajohet si me poshte:

| | 31 dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Mallra per shitje | 21,038,709 | 20,434,754 |
| Vleresimi i inventarit | 20,155 | 72,280 |
| Provision per shitjen e mallrave | (2,194,229) | (1,679,260) |
| **Total** | **18,864,635** | **18,827,774** |



EG

## 10 Aktive afatgjata materiale

| | Permiresimet e ambjenteve me qira | Instalime teknike | Pajisje informative | Pajisje zyre | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| Kosto | | | | | |
| Gjendja me 1 janar 2020 | 55,896,003 | 18,925,024 | 1,209,571 | 3,264,902 | 79,295,500 |
| Shtesa | 1,611,090 | - | 13,441 | - | 1,624,531 |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2020** | **57,507,093** | **18,925,024** | **1,223,012** | **3,264,902** | **80,920,031** |
| Shtesa | - | - | 158,592 | 25,000 | 183,592 |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2021** | **57,507,093** | **18,925,024** | **1,381,604** | **3,289,902** | **81,103,623** |
| Amortizimi | | | | | |
| Gjendja me 1 janar 2020 | (9,316,001) | (3,154,170) | (254,794) | (544,151) | (13,269,116) |
| Amortizimi i vitit | (11,501,419) | (3,785,005) | (305,753) | (652,980) | (16,245,157) |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2020** | **(20,817,420)** | **(6,939,175)** | **(560,547)** | **(1,197,131)** | **(29,514,273)** |
| Amortizimi i vitit | (11,586,213) | (3,785,005) | (306,878) | (656,730) | (16,334,825) |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2021** | **(32,403,633)** | **(10,724,180)** | **(867,425)** | **(1,853,861)** | **(45,849,098)** |
| **Vlera e mbetur** | | | | | |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2020** | **36,689,673** | **11,985,849** | **662,465** | **2,067,771** | **51,405,758** |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2021** | **25,103,461** | **8,200,844** | **514,179** | **1,436,041** | **35,254,525** |



EC

## 11 Aktive afatgjata jo materiale

Aktivet afatgjata jo materiale perbehen nga nje software i blere ne dhjetor 2021:

| | Software |
|---|---|
| Gjendja me 1 janar 2020 | - |
| Shtesa | - |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2020** | - |
| Shtesa | 266,332 |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2021** | **266,332** |
| **Amortizimi** | |
| Gjendja me 1 janar 2020 | - |
| Amortizimi i vitit | - |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2020** | - |
| Amortizimi i vitit | - |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2021** | - |
| **Vlera e mbetur** | |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2020** | - |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2021** | **266,332** |

## 12 Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit detajohen si me poshte:

| | 31 dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Furnitore te huaj | 15,272,716 | 16,073,614 |
| Furnitore lokal | 1,209,059 | 698,713 |
| Kupona per stafin | 221,040 | 99,200 |
| **Totali** | **16,702,815** | **16,871,527** |

## 13 Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit

Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit detajohen si me poshte:

| | 31 dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Te pagueshme per mallra | 2,093,776 | 1,870,402 |
| Te pagueshme per interesa | 72,137 | 70,965 |
| Te pagueshme per sherbime te tjera | 5,189 | 277,054 |
| **Totali** | **2,171,102** | **2,218,421** |



EG

## 14 Te pagueshme ndaj personelit dhe sigurimeve shoqerore

Te pagueshme ndaj personelit dhe sigurimeve shoqerore detajohen si me poshte:

| | 31 dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Paga dhe shperblime | 718,656 | 528,129 |
| Sigurime shoqerore | 221,916 | 157,062 |
| Sigurime shendetesore | 31,109 | 23,022 |
| **Totali** | **971,681** | **708,213** |

## 15 Detyrime tatimore dhe doganore

Detyrimet tatimore dhe doganore detajohen si me poshte:

| | 31 dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Tatimi mbi fitimin | 9,921,490 | 1,645,915 |
| TVSH e pagueshme | 2,768,632 | 1,780,660 |
| Detyrime doganore | 792,418 | 428,149 |
| Tatimi ne burim | 100,291 | 779,239 |
| Tatimi mbi te ardhurat personale | 68,274 | 53,526 |
| **Totali** | **13,651,105** | **4,687,489** |

## 16 Detyrime te tjera

Detyrime te tjera detajohen si me poshte:

| | 31 dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Fatura te pamberritura | 1,410,030 | 1,118,530 |
| Provizion restaurimi | 729,805 | 478,148 |
| Provizion per kthimin e mallrave | 244,001 | 198,447 |
| Auditimi vjetor | 212,968 | 380,000 |
| Te tjera | 204,037 | 151,721 |
| **Total** | **2,800,841** | **2,326,846** |

## 17 Huamarrje

New Yorker Albania e ka paguar gjate vitit 2021 huane e marre nga palet e lidhura:

| | 31 dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Huamarrje afatshkurter | - | 67,725,750 |
| **Totali** | - | **67,725,750** |

## 18 Kapitali aksionar

Kapitali i Shoqerise me 31 Dhjetor 2021 eshte 13,000,000 Leke (31 Dhjetor 2020: 13,000,000 Leke), aksioneri i vetem i shoqerise eshte NEW YORKER Retail International GmbH me seli ne Gjermani.

## 19 Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit detajohen si me poshte:

| | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Shitja e mallrave | 256,544,015 | 164,493,565 |
| **Totali** | **256,544,015** | **164,493,565** |

## 20 Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme

Materiale te konsumueshme detajohen si me poshte:

| | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Blerje | 89,743,583 | 67,905,500 |
| Shpenzime transporti | 6,318,385 | 5,964,482 |
| Tarifa agjenti doganor | 4,263,497 | 1,812,308 |
| Provizione per mallrat per rishitje | - | 1,679,260 |
| Taksat doganore | 958,234 | 1,438,004 |
| Diferenca pozitive inventari | (496,967) | 361,438 |
| Vleresimi i inventarit | - | (72,280) |
| Write off per mallrat e demtuar | 289,769 | (282,385) |
| Diferenca negative inventari | 611,261 | (492,325) |
| **Totali** | **101,687,762** | **78,314,002** |

## 21 Shpenzime personeli

Shpenzime personeli detajohen si me poshte:

| | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Paga dhe shperblime | 9,299,627 | 7,060,598 |
| Sigurime shoqerore dhe shendetesore | 1,620,312 | 1,232,333 |
| **Totali** | **10,919,939** | **8,292,931** |



EG

## 22 Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit detajohen si me poshte:

| | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Qira ambjentesh | 19,567,861 | 13,676,283 |
| Utilitete | 10,001,221 | 9,402,340 |
| Sherbimet e menaxhimit | 8,243,016 | 6,335,957 |
| Sherbime profesionale dhe konsulence | 3,210,648 | 3,226,918 |
| Shpenzime te tjera | 2,584,966 | 2,416,486 |
| Shpenzime per materiale | 1,533,839 | 1,276,026 |
| Komisione bankare | 1,341,688 | 763,217 |
| Shpenzime administrative | 1,339,599 | 1,794,898 |
| Siguracion | 814,061 | 813,423 |
| | **48,636,899** | **39,705,548** |

## 23 Shpenzime financiare

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare detajohen si me poshte:

| | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Fitime nga kembimet valutore | 1,328,616 | 195,966 |
| Shpenzime per interesa | (1,781,189) | (4,896,252) |
| Humbje nga kembimet valutore | (2,600,178) | (3,458,548) |
| **Totali** | **(3,052,752)** | **(8,158,834)** |

## 24 Tatim fitimi

Tatim fitimi per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021/31 dhjetor 2020 sipas pasqyres se performances detajohet si me poshte:

| | 31 dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Fitimi neto para tatimit | 75,911,839 | 13,777,093 |
| *Shpenzime te pazbritshme per qellime tatimore* | *8,976,748* | *2,953,496* |
| **Fitimi i tatueshem i vitit** | **84,888,587** | **16,730,589** |
| Tatim fitimi 15% (2020: 15%) | 12,733,288 | 2,509,588 |
| Parapagime | 2,811,798 | 863,673 |
| **Per t'u paguar deri me 31 mars 2022/2021** | **9,921,490** | **1,645,915** |



EG

## 25 Instrumentat financiare

### Ekspozimi ndaj rrezikut te kredise

Vlera kontabel e aktiveve financiare perfaqeson ekspozimin maksimal ndaj rrezikut te kredise. Ekspozimi maksimal ne daten e raportimit ishte:

| | 31 dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 66,126,083 | 46,327,867 |
| Te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit | 293,945 | 54,164 |
| Te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit | - | 49,124 |
| **Total** | **66,420,028** | **46,431,155** |



EG

## 25 Instrumentat financiare (vazhdim)

**Ekspozimi ndaj rrezikut te likuiditetit**

Me poshte paraqiten aktivet dhe detyrimet financiare sipas maturitetit te mbetur me 31 dhjetor 2021 dhe 2020:

| | 31 dhjetor 2021 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Deri ne 6 muaj** | **6 deri ne 12 muaj** | **1 deri ne 5 vjet** | **Mbi 5 vjet** | **Totali** |
| Te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit | 293,945 | - | - | - | 293,945 |
| Te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit | - | - | - | - | - |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 66,126,083 | - | - | - | 66,126,083 |
| | **66,420,028** | - | - | - | **66,420,028** |
| Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit | 16,702,815 | - | - | - | 16,702,815 |
| Te pagueshme per njesite ekonomike brenda grupit | 2,171,102 | - | - | - | 2,171,102 |
| Detyrime te tjera | 17,423,627 | - | - | - | 17,423,627 |
| Huamarrje | - | - | - | - | - |
| | **36,297,544** | - | - | - | **36,297,544** |
| **Rreziku i likuiditetit me 31 dhjetor 2021** | **30,122,484** | - | - | - | **30,122,484** |

| | 31 dhjetor 2020 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Deri ne 6 muaj** | **6 deri ne 12 muaj** | **1 deri ne 5 vjet** | **Mbi 5 vjet** | **Totali** |
| Te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit | 54,164 | - | - | - | 54,164 |
| Te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit | 49,124 | - | - | - | 49,124 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 46,327,867 | - | - | - | 46,327,867 |
| | **46,431,155** | - | - | - | **46,431,155** |
| Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit | 16,871,527 | - | - | - | 16,871,527 |
| Te pagueshme per njesite ekonomike brenda grupit | 2,218,421 | - | - | - | 2,218,421 |
| Detyrime te tjera | 7,722,548 | - | - | - | 7,722,548 |
| Huamarrje | | 67,725,750 | - | | 67,725,750 |
| | **26,812,496** | **67,725,750** | - | - | **94,538,246** |
| **Rreziku i likuiditetit me 31 dhjetor 2020** | **19,618,659** | **(67,725,750)** | - | - | **(48,107,091)** |



EG

## 25 Instrumentat financiare (vazhdim)

**Ekspozimi ndaj rrezikut valutor**

Kurset e kembimit ne fund te periudhes raportuese jane si meposhte:

| | 31 dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| EURO 1 | 120.76 | 123.70 |

## 26 Transaksionet me palet e lidhura

Shoqeria ka kryer transaksione me shoqerine meme dhe shoqerite brenda grupit. Tabelat e meposhtme permbledhin qellimet dhe balancat nga transaksionet me palet e lidhura:

| Pasqyra e pozicionit financiar | 31 dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Te arketushme nga New Yorker Group Services | 125,591 | 13,360 |
| Te arketushme nga New Yorker Information Services | 98,299 | - |
| Te arketushme nga New Yorker Fashion Logistics | 153,985 | 49,124 |
| **Totali** | **377,875** | **62,484** |

| Pasqyra e pozicionit financiar | 31 dhjetor 2021 | 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| Te pagueshme per New Yorker Fashion Logistics | 2,093,776 | 1,870,402 |
| Te pagueshme per New Yorker Austria | 205,660 | |
| Te pagueshme per New Yorker Financial Services International | 157,230 | |
| Te pagueshme per New Yorker Marketing & Media | 42,241 | 58,139 |
| Te pagueshme per New Yorker Store Development | 32,131 | 26,185 |
| Te pagueshme per New Yorker Retail | 17,939 | 68,002,804 |
| **Totali** | **2,548,977** | **69,957,530** |

| Pasqyra e performances | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 | Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 |
|---|---|---|
| *Shpenzime* | | |
| Blerja e mallrave | 90,217,442 | 66,548,487 |
| Sherbime financiare | 2,816,768 | 2,706,510 |
| Te tjera | 2,340,493 | 2,263,771 |
| Shpenzime interesi | 1,781,189 | 4,464,114 |
| Shpenzime per materiale | 1,756,061 | 1,052,550 |
| Administrimi i faturimeve | 1,264,667 | |
| Sherbime marketing | 774,419 | 646,309 |
| Kontrolli i shitjeve | 744,138 | 667,054 |
| Garanci bankare | 50,874 | 52,314 |
| | | |
| *Te ardhura* | | |
| Te tjera | - | - |



EG

## 27 Ngjarje pas dates se raportimit

Qe nga janari 2020, virusi SARS-CoV-2 eshte zhvilluar me shpejtesi ne nje pandemi globale, duke kufizuar masivisht jeten ekonomike dhe publike si dhe jeten private te pothuajse te gjithe qytetareve. Ashtu si ne vitin 2020, shkalla e infeksionit u rrit ndjeshem ne vjeshten e 2021 deri ne 2022.

Masat shtrenguese vazhdojne deri me sot: kufizime ne oret e hapjes dhe numri i vizitoreve ne dyqane me detyrimin per mbajtjen e maskave te fytyres dhe mbajtjen e distances se sigurise.

Zhvillimi i metejshem i pandemise, edhe ne lidhje me mutacionet e shumta dhe agresive, eshte ende i paparashikueshem. Ndikimi i masave politike, urdhrave dhe kufizimeve ne jeten e njerezve dhe pranimi i tyre eshte i veshtire te parashikohet. Si rezultat, as pasojat e pergjithshme dhe as ato specifike ekonomike te pandemise se Corona nuk jane te parashikueshme per NY Albania. Per vitin 2022, Shoqeria vazhdon te parashikoje kufizime te lidhura me pandemine ne biznes, duke perfshire mbylljet selektive te dyqaneve dhe kufizimet e vazhdueshme ne marredhenien me klientet.

Shoqeria ka permbushur vazhdimisht detyrimet e saj financiare gjate pandemise COVID 19 deri me sot. Sipas opinionit te manaxhimit, aktualisht vazhdimi i veprimtarise se Shoqerise nuk eshte ne rrezik.

Që nga Shkurti i vitit 2022, ka vazhduar konflikti midis Ukraines dhe Federates Ruse.

Zhvillimi dhe intensiteti i metejshëm i ngjarjeve aktuale nuk mund te parashikohet ne kete moment.

Ndikimi ekonomik, ne ekonomine evropiane dhe globale, veçanerisht në lidhje me efektet e sanksioneve ekzistuese ose të ardhshme kundër Federates Ruse, si dhe sanksionet nga Federata Ruse eshte e veshtire te parashikohet, siç jane efektet direkte dhe indirekte ne furnizimin me energji dhe zinxhiret e furnizimit global. NEW YORKER do te monitoroje zhvillimin e metejshem te konfliktit dhe do te ndermarre masat e duhura aty ku eshte e mundur.

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.



EG